



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.35.1- 2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË KLLOKOTIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Klllokotit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Astrit Bllaca, i mbështetur nga Faik Thaqi (udhëheqës ekipi), dhe Senver Morina.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	23
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	24
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	27


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Klllokotit për vitin 2015 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 22.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën 1të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse ka paqartësi në prezantimin e plotë të vlerës së pasurive. Për më tepër, tokat dhe automjetet e komunës, nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël SIMFK.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi te nën kapitulli 1.2 i këtij raporti

## Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm, i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha, por dobësitë ende janë të pranishme në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



## Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E KLLOKOTIT

### **OPINIONI I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES**

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kllokotit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Kllokotit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

### **Baza për Opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me

këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Theksimi i Çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna nuk kishte formuar komision për inventarizimin e pasurisë. Po ashtu, tokat dhe automjetet e komunës, nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël SIMFK si dhe nuk janë prezantuar në PVF. Kjo ka ndikuar që pasuritë janë nënvlerësuar për tokat dhe automjetet. Opinioni ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - (SNKSP) Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i siguri, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga

entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 22.10.2015 është identifikuar një rrezik për PVF-të, dhe si i tillë mund të rezultojë në theksim të çështjes. Rreziku ka të bëjë me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurisë. Komuna nuk kishte formuar komision për inventarizimin e pasurisë. Po ashtu, tokat dhe automjetet e komunës, nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël SIMFK dhe nuk janë prezantuar në PVF. Ky rrezik është materializuar sepse nga menaxhmenti nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për ta adresuar rrezikun e paraqitur.

## 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime).
- Kërkesat e buxhetit;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga ZKF dhe Kryetari;
- Nëse PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.



Menaxhmenti nuk ka zbatuar një rishikim efektiv të procesit të përgatitjes së PVF-ve i cili ka rezultuar me gabime si në vijim:

- Neni 23, raporti për veprimet e ndërmarra për rekomandimet e dhëna nga AP për vitin paraprak nuk ishte plotësuar.
- Neni 16, tek shpalosja e pasurive nuk ishte ndarë vlera sipas kategorive, si dhe pasuritë nën 1000€, nuk përmbanin vlerat aktuale.
- Tek shpalosja e obligimeve janë paraqitur edhe detyrimet kontingjente.

Të gjeturat më lartë tregojnë që përgatitja e PVF -ve nuk ishte menaxhuar në mënyrën e duhur.

#### DEKLARATA E BËRË NGA KRYETARI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e pasaktë për çështjet e përmendura më lart, por që nuk janë materiale për ta modifikuar opinionin.

## 1.5 Rekomandimet

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura përfshirë rrezikun domethënës për pasuritë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe tek fushat ku janë identifikuar gabime.

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo reflekton përkushtimin e menaxhmentit për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që do të duhej të plotësohet nga komuna siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e pa plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë të qeverisjes. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes janë, si: përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit, menaxhimi dhe monitorimi sistematik i buxhetit, etj.

### 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të Komunës së Kllokotit ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Komuna nuk kishte përgatitur ndonjë Plan Veprimi për veprimet dhe masat e implementimit të rekomandimeve të dhëna. Megjithatë, deri në datën e auditimit për vitin 2015, katër (4) rekomandime janë implementuar; katër (4) janë në proces të adresimit dhe katër (4) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Raporti i auditimit të vitit 2014, nuk ishte diskutuar edhe në Asamblenë Komunale.

### Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse komuna nuk ka përgatitur plan veprimi e as që ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kanë rezultuar në:
- Mos-efikasitet të vazhdueshëm në identifikimin, regjistrimin e pasurisë dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare;
  - Dobësi të vazhdueshme në menaxhimin e të hyrave vetjake; dhe
  - Menaxhim të dobët të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të hartoj një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të këtij raporti dhe rekomandimeve të mëhershme dhe të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me këtë plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuara me prioritet të lartë.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF.

### Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna e Klokotit nuk kishte përmbushur detyrimin për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit, dhe për këtë arsye ne nuk kemi arritur që të shqyrtojmë asnjë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit të cilat lidheshin me komponentat e caktuara.
- Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është përgjegjës për përpilimin dhe rishikimin e kësaj liste.

- Rreziku** Mos plotësimi i pyetësorit së vetëvlerësimit, përveç që është mos përmbushje e kërkesës statutore, nuk mundëson pasqyrimin e përparësive dhe të metave të sistemeve të menaxhimit financiar dhe operimit të kontrolleve të komunës.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar kërkesa për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe sistematike.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Komuna pritet të zbatoj vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

#### Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk ka hartuar një regjistër të rreziqeve së bashku me reagimet alternative në rast të ndodhjes së tyre, të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave të organizatës. Kjo mund të jetë reflektim i mungesës së njohurive lidhur me konceptin dhe rëndësinë e procesit të menaxhimit të rrezikut.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë mundësinë e menaxhmentit për të marrë masat dhe veprimet e duhura për reduktimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm për të evituar devijimin e proceseve nga ecuritë normale.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar një listë ku rreziqet janë identifikuar sipas niveleve dhe gjasave që ato mund të ndodhin, si dhe janë parashikuar masat si kundërpërgjigje nëse ato ndodhin. Gjithashtu, përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut duhet të delegohet tek një përgjegjës i cili do të raportoj tek menaxhmenti dhe të sigurojë zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

## 2.5.2 Plani strategjik i Komunës

---

### Çështja 4 - Mungesa e planit Strategjik - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk posedon plan strategjik me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili prezanton orientimin dhe synimet e komunës në një periudhë afatmesme të zhvillimit.
- Rreziku** Mungesa e planit strategjik rrezikon prioritet e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e komunës në periudha afatgjata.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna nuk ka në funksion auditimin e brendshëm. U/A nr. 23/2009, rregullon rastet kur organizatat nuk e kanë në funksion auditimin e brendshëm dhe ofron mënyra tjera të sigurimit të këtyre shërbimeve.

---

### Çështja 5 - Mungesa e Auditimit të Brendshëm - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Komuna nuk ka bërë përpjekje që shërbimet e auditimit të brendshëm t'i siguroj nga bashkëpunimi me ndonjë organizatë tjetër buxhetore ose të kërkoj mbështetje nga Ministria e Financave.
- Rreziku** Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shërbimi i auditimit të brendshëm, kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë komunë tjetër. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Komuna e kupton rëndësinë një sistemi adekuat dhe të fortë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>794,796</b>	<b>967,209</b>	<b>853,340</b>	<b>816,101</b>	<b>1,072,248</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	707,947	770,874	770,847	771,790	869,506
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	97,542	0	39,235	93,399
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	86,849	86,849	82,493	5,076	41,407
Donacionet e jashtme	0	11,944	0	0	67,936

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 172,413€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të Qeverisë për pagesën e obligimeve nga vitet e kaluara në vlerë 60,000€, ndarjes për kompensimin

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

e përvojës së punës në vlerë 2,927€, donacioneve të jashtme si dhe bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2014.

Në vitin 2015, komuna i ka përdorur 88% të buxhet final ose 853,340€, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2014. Performanca buxhetore është nën mesataren e komunave tjera.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>794,796</b>	<b>967,209</b>	<b>853,340</b>	<b>816,101</b>	<b>980,973</b>
Pagat dhe Mëditjet	670,000	672,928	672,928	575,683	554,007
Mallrat dhe Shërbimet	68,796	140,140	124,623	75,974	152,373
Shërbimet komunale	17,200	30,017	17,155	23,180	17,508
Subvencionet dhe Transferet	2,000	7,350	1,999	4,650	4,800
Investimet Kapitale	36,800	116,774	36,635	136,614	252,285

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale për 79,974€, vetëm 36,635€ apo 31% e këtij buxheti ishte shpenzuar. Rritja në këtë kategori nga të hyrat e bartura nuk ishte aprovuar nga asambleja komunale. Mjetet ishin aprovuar me vonesë në fund të dhjetorit, dhe për këtë arsye nuk ka qenë e mundur të shpenzohen. Në mënyrë të njëjtë kishte ndikuar edhe në kategoritë tjera.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	86,849	86,849	90,320	116,032	96,948

Të hyrat vetjake të realizuara gjatë vitit 2015 në vlerë 90,320€, ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e komunës dhe janë shpenzuar 82,493€. Pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara që nuk janë shpenzuar në vlerë totale 105,370€, janë bartur për shpenzim në vitin 2016.

## Çështja 6 - Ekzekutimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Mos ekzekutimi e buxhetit është ndikuar nga të hyrat vetjake të vitit të kaluar në vlerë 97,542€, të cilat nuk ishin aprovuar nga asambleja komunale që të shpenzoheshin për projektet e planifikuara. Si rezultat i menaxhimit të dobët të të hyrave, një pjesë e konsiderueshme e të hyrave nga dy vitet e kaluara është bartur në vitin 2016.
- Rreziku** Ekzekutimi i dobët i buxhetit, në veçanti në kategorinë e investimeve kapitale, ka rezultuar me shfrytëzimin jo efikas të fondeve në dispozicion dhe mos realizimin e projekteve kapitale.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim të arsyeve për mos ekzekutim të buxhetit dhe të sigurojë një planifikim të mirëfilltë i cili bazohet në kërkesat reale si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit.

## 3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë shpenzimet për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me komunalitë, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat me bashkëfinancim.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.



### 3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 672,928€, të cilat ishin shpenzuar në shkallën maksimale 100%. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollët që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

#### Rekomandimi

---

##### Çështja 7 – Pagesa të shërbimeve kontraktuese - Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Komuna përmes konkursit publik ka pranuar shtatë (7) punëtorë të sigurimit me kohë të caktuar, duke u bazuar në Ligjin e punës nr.03/L-2012 dhe duke i paguar gjatë tërë vitit nga mallrat dhe shërbimet (shërbime kontraktuese). Kontrata për detyra specifike sipas këtij ligji neni 10 nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë brenda një viti.

**Rreziku** Vazhdimi i këtyre kontratave rritë rrezikun që shërbimet e tilla të mos përkrijnë me nevojat reale të komunës dhe që buxheti i planifikuar për këtë kategori të mos shpenzohet sipas qëllimit të caktuar.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj se kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për shërbime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 120 ditë, siç e përcakton ligji. Në rast të vlerësimit për nevoja të angazhimeve afatgjata, duhet të shpallen procedura të rregullta rekrutimi.

### 3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet janë kategori e ndihmave financiare që u jepen përfituesve nga komuna pa kthim të drejtpërdrejt, në shumat e përcaktuara me rregulloren komunale. Ato kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik në nevojë. Kontrollët e zbatuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike.

Buxheti për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2015, ishte 7,350€. Nga kjo kategori ishin shpenzuar 1,999€.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

---

### 3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2015 ishin 90,320€. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat e subjekteve biznesore, taksa administrative, etj. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së të hyrave dhe sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimeve.

#### Rekomandimet

---

##### Çështja 8 – Mos deklarim i drejt i të hyrave – Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna gjatë vitit 2015 nuk ka bërë regjistrime të pronave të reja, dhe as ndonjë vlerësim të pronave ekzistuese. Ne gjatë auditimit kemi siguruar dëshmi se në vitin 2016 komuna veç ka filluar me regjistrimet e reja të cilat sipas vlerësimeve fillestare, do të ndikojnë në rritjen e të hyrave të vitit 2016 për 16,479€.

Komuna inkason të hyra nga taksat për shërbime të qytetarëve (grumbullimi i mbeturinave), të cilat nuk i ka regjistruar si të hyra të vitit 2015. Prej tyre 30 bllok dëftesa në vlerë totale 3,770€, janë dërguar në llogarinë e komunës tek në vitin 2016. Po ashtu, ne kemi gjetur se janë paguar me bllok dëftesa vlera më të mëdha se 10€, e jo sipas rregullores së thesarit.

**Rreziku** Mos regjistrimi i pronave të reja, mos vlerësimi i pronave ekzistuese si dhe mos regjistrimi i të hyrave në sistem rritë rrezikun e drejtpërdrejt që të hyrat e komunës të mos jenë reale, çka mund të rezultojë me humbje financiare për komunën. Pranimi i parave kesh në shuma mbi 10€, kur ekziston llogaria e komunës, bie ndesh me Rregullat e Thesarit dhe rrezikon, që paratë të keqpërdoren ose humbin.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimet për pronat të kryhen me kohë dhe të vendosë kontrole të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, regjistrimit barazimit dhe raportimit të hyrave vetjake. Të ndërpres praktikatat aktuale të inkasimit të pagesave mbi 10€ dhe këto pagesa të kryhen përmes llogarisë bankare. Ndërsa, pagesat e inkasuara nën këtë shumë, duhet të deponohen brenda 24 orësh në llogarinë bankare të autorizuar nga komuna.

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Vlera neto e pasurive të komunës në vitin 2015 ishte 1,663,657€ dhe është shpalosur në PVF.

Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 1.3 Rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare.

---

#### Çështja 9 - Mos përdorimi i sistemit E-pasuria - Prioritet i mesëm

- |                       |  |
|-----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>      | Pasuritë e komunës me vlerë nën 1,000€, nuk ishin regjistruar në sistemin e E-pasuria, e as në ndonjë format tjetër, siç kërkohet në Rregulloren MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë.  |
| <b>Rreziku</b>        | Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pasurive të cilat janë në pronësi të komunës, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive. Po ashtu, kjo e rritë rrezikun e humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre.   |
| <b>Rekomandimi 10</b> | Kryetari duhet të siguroj marrjen e masave të menjëhershme dhe të inicioj regjistrimin e të gjitha pasurive në Sistemin E-pasuria. Nëse sistemi nuk mund të përdoret për arsye të ndryshme, regjistrimet të bëhen përmes ndonjë programi tjetër, i cili siguron plotësinë dhe saktësinë e regjistrimeve. |

### 3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme

Paraja e gatshme është fond i vogël i parave i cili mbahet nën kontrollin e organizatës buxhetore, i cili shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet për blerjet e ndryshme me vlera të vogla, deri në 100€.

#### Rekomandimi

---

#### Çështja 10 - Blerjet me para të gatshme - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Komuna, për blerjet që kanë mundur të planifikohen edhe me plan prokurimi, kishte përdorur paranë e imtë. Blerjet ishin për servisim të automjeteve, ndërrimin e autogomave, derivate, dreka zyrtare etj. Po ashtu, tek faturat ka munguar emri i blerësit, gjegjësisht i komunës, dhe nuk dihet nëse blerjet ishin për interes të saj.

**Rreziku** Blerja e mallrave jashtë rregullave të Thesarit si dhe pranimi i faturave jo të rregullta, rrit rrezikun e keqpërdorimit të parasë së imtë.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të shtoj masat e kontrollit në zbatimin e rregulloreve të Thesarit dhe të siguroj se paraja e imtë do të shpenzohet në pajtim të plotë me procedurat e shpenzimeve. Blerjet që mund të parashihen me planin vjetor të prokurimit, nuk duhet të jenë subjekt i blerjeve me para të imta.

### 3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Komuna nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, të hyrat nga qiratë dhe taksat e aktivitetit të biznesit. Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave të grumbulluara, ka rezultuar me nivele të larta të llogarive të arkëtueshme. Megjithatë, vlen të theksohet se ligji për faljen e borxheve mund të ketë ndikuar në rënien e normës së inkasimit të borxheve të mbetura nga vitet e kaluara.

---

#### Çështja 11 - Rritja e llogarive të arkëtueshmeve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Borxhet totale ndaj komunës, në fund të vitit 2015 ishin 407,098€€, me një rritje të theksuar prej 32% nga viti i kaluar. Sfida kryesore mbetet inkasimi i tatimit në pronë në vlerë 317,163€, pastaj, taksat nga veprimtaritë e biznesit 70,345€, qiraja nga prona dhe objektet 19,590€.

- Komuna e Kllkotit kishte planifikuar që nga tatimi në pronë të inkasoj vlerën 68,500€, por gjatë vitit, ka arritur të inkasoj vetëm 34,320€ apo 50%, të planifikimit.
- Në gjashtë raste identifikua që përdoruesit e pronave komunale nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj komunës. Ngarkesa mujore për këto raste ishte 2,305€, ndërsa borxhet e mbledhura gjatë viteve ishin 19,590€.
- Në territorin e komunës së Kllkotit veprimtarinë biznesore e zhvillojnë 108 biznese. Faturimi për vitin 2015 ishte 15,415€€, ndërsa janë inkasuar vetëm 1,405€ apo 9%.

**Rreziku** Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, mund të rezultojë me rritjen e këtyre llogarive, madje me mundësinë që ato të mos mbledhen fare, dhe rrjedhimisht edhe me humbje financiare për komunën. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.

### 3.7.4 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 228,581€. Në këto detyrime janë përfshirë edhe detyrimet kontingjente nga pretendimet për borxhet e viteve paraprake përmes gjykatave dhe përmbaruesve privat në vlerë 85,041€. Detyrimet janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

---

#### Çështja 12 – Nivel i lartë i obligimeve -Prioritet i lartë

**E gjetura** Obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente kanë arritur vlerën e përbashkët në total prej 228,581€, apo 24% e tërë buxhetit final. Komuna nuk kishte arritur të bëjë një ndarje të qartë në mes të obligimeve të rregullta dhe detyrimeve kontingjente, andaj tek obligimet në PVF i kishte paraqitur edhe detyrimet kontingjente.

Pjesa më e madhe e këtyre obligimeve ndaj operatorëve ekonomik, janë bartur nga vitet e mëhershme. Libri për pranimin e faturave (Libri i Protokollit), ende nuk është i plotë për faktin se ka filluar të aplikohet në vitin 2014, ndërsa një pjesë e madhe e obligimeve i takojnë viteve të më hershme të cilat ende nuk janë të regjistruara në libër.

**Rreziku** Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe detyrimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Fakti që komuna ka 24% të buxhetit detyrime, mund të rrezikoj seriozisht ekuilibrin buxhetor dhe të sjellë komunën në një situatë tejet të vështirë financiare.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Një opsion i sugjeruar do të ishte që problemin e borxheve të prapambetura, komuna ta diskutoj edhe me Qeverinë.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
<b>Çështja 1</b> Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF	<b>Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë</b> Kryetari i Komunës duhet të siguroj një rishikim të proceseve ekzistuese për menaxhimin e pasurive. Hapi i parë në këtë drejtim duhet të jetë inventarizimi vjetor i pasurive në dispozicion, dhe më pas të vazhdohet me regjistrimin e pronave dhe objekteve tjera në pronësi të komunës që janë përfituar në vitet e kaluara. Kryetari i komunës duhet ta monitorojë procesin për të siguruar një regjistër të plotë të pasurive të prezantuar në PVF- të e vitit 2015.			x
<b>Çështja 2</b> Procesi i hartimit të PVF-ve dhe kërkesat tjera për raportim – Prioritet i Lartë	<b>Rekomandimi 2</b> Kryetari i Komunës duhet të inicoj një analizë të arsyeve që kanë çuar në gabimet materiale dhe mospajtueshmëritë në draft PVF. Kryetari duhet të diskutoj me ZKF pse ekzistojnë gabimet e tilla, dhe nëse vlerësohet e nevojshme, të ndiqen trajnime nga Thesari apo të shfrytëzohen përvojat e komunave tjera të cilat kanë njohuritë e mjaftueshme për hartimin cilësor të PVF-ve. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse draft PVF-të i nënshtrohen kontrolleve përfundimtare dhe konfirmohen si të sakta.			x
<b>Çështja 3</b> Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i Lartë	<b>Rekomandimi 3</b> Kryetari duhet të sigurojë një plan efektiv për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2013 dhe 2014. Ky plan duhet t'i identifikojë afatet kohore, aktivitetet dhe stafin përgjegjës për zbatim të rekomandimeve, si dhe të përqendrohet fillimisht në fushat e rëndësishme më të madhe. Progresi i zbatimit të këtij plani duhet të monitorohet direkt nga ana e Kryetarit.			x

<p><b>Çështja 4</b> Dobësitë në kontrollet e menaxhmentit të lartë – Prioritet i Lartë</p>	<p><b>Rekomandimi 4</b> Kryetari i Komunës duhet të siguroj një rishikim të gjendjes së tanishme për të përcaktuar pse ekziston një cilësi e dobët e raportimit të brendshëm dhe t'i vendosë dhe/apo forcojë kontrollet për të siguruar një raportim dhe llogaridhënie të fortë brenda komunës. Kërkesat e MFK-së duhet të zbatohen për të përmirësuar mjedisin e kontrollit. Veprime konkrete dhe të përshtatshme duhet të ndërmerren deri në fund të vitit 2015.</p>	x		
<p><b>Çështja 5</b> Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë</p>	<p><b>Rekomandimi 5</b> Kryetari i Komunës duhet fillimisht t'i identifikoj cilat ishin arsyet/barrierat për këtë performancë të ultë buxhetore, dhe më pas të vendos praktika të rregullta për monitorim sistematik të ecurive buxhetore. Ne do të sugjeronim që ecuritë buxhetore të shqyrtohen çdo muaj nga ana e menaxhmentit dhe të merren masa/veprime konkrete aty ku pengesat identifikohen.</p>		x	
<p><b>Çështja 6</b> Dobësi në prokurim – Prioritet i Lartë</p>	<p><b>Rekomandimi 6</b> Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që brenda një afati sa më të shpejtë ta plotësojë pozitën e zyrtarit të prokurimit dhe të siguroj se procesi i prokurimit i nënshtrohet të gjitha kërkesave dhe zbatohet konform rregullave në fuqi. Secili prokurim duhet të zhvillohet sipas procedurave normale dhe të dokumentohet që nga planifikimi e deri në fazën e pranimi të shërbimeve.</p>	x		

<p><b>Çështja 7</b> Marrëveshjet për bashkëfinancim – Prioritet i Lartë</p>	<p><b>Rekomandimi 7</b> Kryetari i Komunës t’i rishikojë marrëveshjet për bashkëfinancim për të siguruar që të gjitha shpenzimet bëhen në përputhje të plotë me ligjet. Me rastin e hyrjes në financime të përbashkëta, Kryetari i Komunës duhet në mënyrë specifike t’i analizoj dispozitat e marrëveshjes, të drejtat dhe detyrimet e palëve në marrëveshje dhe kushtet e veçanta të marrëveshjes. Procesi i monitorimit të këtyre projekteve duhet të bëhet që nga nënshkrimi i marrëveshjes deri në përfundim të tyre nga ana e ekipeve të përbashkëta dhe të rezultoj me një raport final të pranimit. Praktika e pagesave në avans duhet të sqarohet dhe të përjashtohet nga objekti i marrëveshjeve të tilla.</p>		x	
<p><b>Çështja 8</b> Drekat zyrtare – Prioritet i Mesëm</p>	<p><b>Rekomandimi 8</b> Kryetari i Komunës duhet të siguroj se procedurat e organizimit të drekave zyrtare janë zbatuar dhe t’i forcojë kontrollet për të siguruar që të gjitha shpenzimet e tilla janë raportuar dhe dokumentuar në pajtim me rregulloret dhe në përputhje me objektivat e komunës.</p>		x	
<p><b>Çështja 9</b> Dobësi në pagesat për punonjës – Prioritet i Mesëm</p> <p><b>Çështja 10</b> Dobësi në ndarjen e subvencioneve – Prioritet i Mesëm</p>	<p><b>Rekomandimi 9</b> Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shkollat do të përdorin kritere dhe trajtim të barabartë për stafin e nivelit të njëjtë. Mbajtja e pozitave të drejtorëve të tri departamenteve nga një person i vetëm, duhet të rishikohet dhe një zgjidhje praktike të ofrohet deri në fund të vitit 2015.</p> <p><b>Rekomandimi 10</b> Kryetari i Komunës duhet t’i forcojë kontrollet mbi subvecnionet për të siguruar që të gjitha subvencionet ndahen në pajtim të plotë me kërkesat e rregullores së brendshme. Të gjithë përfituesit duhet të raportojnë në komunë mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve të përfituara përmes subvencioneve</p>			x

<p><b>Çështja 11</b> Obligimet e papaguara – Prioritet i Mesëm</p>	<p><b>Rekomandimi 11</b> Kryetari i Komunës duhet të siguroj se që përmes planifikimit më të mirë dhe monitorimit të rregullt të fondeve buxhetore, ta prioritzoj likuidimin e obligimeve të mbetura dhe të shmang zgjidhjen e kontesteve përmes gjyqit. Identifikimi i saktë dhe i pa kontestueshëm i detyrimeve të mbetura, duhet të jetë hapi i parë drejt zgjidhjes së problemit.</p>		x	
<p><b>Çështja 12</b> Mungesa e NjAB dhe Komitetit të Auditimit – Prioritet i Lartë</p>	<p><b>Rekomandimi 12</b> Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se sistemi i Auditimit të Brendshëm është funksionalizuar. Ose NJAB mund të themelohet ose këto shërbime mund të sigurohen prej ndonjë njësie jashtë komune. Komiteti i Auditimit duhet të themelohet.</p>	x		